



Prot. Datë 07.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1352/Prot
63

Tiranë, më 02.04 2026

Lënda: Dërgohet Raport Auditimi

QENDRËS KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE



TIRANË

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni Raportin e Auditimit të hartuar në zbatim të Programit të Auditimit miratuar me shkresë nr. 520/1 prot., datë 26.01.2026.

“Plani i Veprimit” të përditësohet dhe të miratohet nga titullari i institucionit, në të cilën duhet të përfshihet rekomandimi me status “Në proces”.

Të njoftohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm mbi zbatimin e rekomandimit sipas afateve të përcaktuara në “Plan Veprimi”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI

Gerald XHELILAJ



RAPORT AUDITIMI

Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në Qendrën Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, referuar Programit të Angazhimit të Auditimit miratuar me shkresë nr. 520/1 prot., datë 26.01.2026, u krye auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit të ushtruar në Drejtorinë e Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë.

Grupi i auditimit: Anesti Gjika
Flobec Guxho

Periudha objekt auditimi: 01.01.2023 – 31.07.2024

Kohëzgjatja e auditimit: 02.02.2026 – 31.03.2026

Raport Përfundimtar shkresë nr. 895/27prot., datë 02.05.2025.

Drejtoria e Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore ka miratuar Planin e Veprimit dërguar me shkresë nr. 33/3 prot., datë 03.06.2025, në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, neni 12/d.

Në komunikimin me strukturat përgjegjëse për burimet njerëzore dhe zyrën e financës rezultoi se nga ana e tyre është reaguar lidhur me rekomandimet e lëna pavarësisht se nuk ka një plan masash të dalë në zbatim të raportit të auditimit.

Referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Planit të Veprimit dërguar me shkresë nr. 33/3 prot., datë 03.06.2025 janë lënë gjithsej 4 rekomandime.

Nga verifikimi i kryer në subjekt lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezulton si më poshtë:

Rekomandimi nr. 1

Listëprezenca të hartohen të ndara për stafin e organikës së miratuar dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.

-Për stafin e organikës të hartohet sipas sektorëve dhe shërbimeve referuar strukturës së miratuar, duke pasur parasysh nënshkrimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit;

-Për punonjësit me kontratë të përkohshme të hartohet sipas sektorëve apo shërbimeve për të cilët janë kontraktuar, duke pasur parasysh nënshkrimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit.

-Për shoferët e autoambulancave prezenca në punë të pasqyrohet sipas ditëve dhe shërbimit të kryer, siç është vepruar për mjekët dhe infermierët.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdim
Niveli i riskut: I lartë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar

Ky rekomandim ka gjetur zbatim nga ana e Institucionit, ku janë hartuar të ndara listë prezenca sipas sektorëve kjo referuar strukturës së miratuar ku janë nënshkruar nga eprori direkt, burimet

njerëzore dhe titullari i institucionit. Për shoferët e autoambulancave prezenca në punë është pasqyruar sipas ditëve dhe shërbimit të kryer.

Rekomandimi nr. 2

Listë prezencat në çdo rast, të shoqërohen me grafikët e shërbimit sëbashku me ndryshimet (nëse do të ketë).

Gjithashtu listëprezencat dhe grafikët e shërbimit të jenë pjesë e dokumentacionit justifikues të listë pagesave.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdim
Niveli i riskut: I lartë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar

Listë prezenca është shoqëruar dhe me grafikun e shërbimit.

Gjatë auditimit u kërkua listë pagesa për muajin Nëntor 2025. Nga verifikimi rezultoi se listë prezencat shoqërohen me grafikët e shërbimit së bashku me ndryshimet gjithashtu listëprezencat dhe grafikët e shërbimit janë pjesë e dokumentacionit justifikues të listë pagesave .

Rekomandimi nr. 3

QKUM të paraqesë situatën e krijuar pranë drejtorive përkatëse përgjegjëse për burimet njerëzore, buxhetin dhe çështjet juridike në MSHMS për të saktësuar elementët shtesë në pagë për mjekët, infermierët dhe shoferët e autoambulancave të cilët kryejnë shërbim urgjence paraspitalore, ose për të bërë rregullimet e duhura në vendimin e pagave.

I njëjti veprim të kryhet dhe për mjekët dhe infermierët pjesë e Sektorit të Njesisë së Koordinimit, pasi nga ana e tyre kryhet shërbim me sistem 12-orë.

Afati: Menjëherë
Niveli i riskut: I lartë

Statusi i rekomandimit: Në Proces

Nga ana e QKUM ka nisur procesin për kwtw rekomandim duke saktësuar dhe me deokumentacionin bashkëshoqerues shkresën nr.106 prot., datë 12.02.2025 kërkesë për saktësimin e elementëve të pagave të punonjësve të QKUM-së, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Vendimi Nr.70, datë 29.01.2025 "Për disa ndryshime për miratimin e strukturës organizative të QKUM-së" dhe në listë pagesat e muajt Nëntor 2024 dhe Prill 2025, janë saktësuar elementët shtesë në pagë për mjekët, infermierët dhe shoferët e autoambulancave të cilët kryejnë shërbim urgjence para spitalorë, gjithashtu dhe për mjekët dhe infermierët pjesë e Sektorit të Njesisë së Koordinimit, që kanë kryer shërbim me sistem 12-orë.

Rekomandimi nr. 4

Për shoferët e autoambulancave, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, të fillojë procedurat siç parashikohet në pikën 10 të VKM nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, për rishikimin e shtesës mbi pagë për shkallën e vështirësisë dhe të dëmshmërisë.

Ky rekomandim vlen edhe për punonjësit e tjerë mbështetës, pasi kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin kanë ndryshuar që në vitin 2022 (trajtuar me referenca ligjore në paragrafët më lart).

Për këtë, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore duhet të ketë parasysh periudhën kur janë kryer miratimet e procedurave dhe ndryshimet e kriteve në dispozitat ligjore.

Afati: Menjëherë

Niveli i riskut: I lartë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar

Nga ana e QKUM ky rekomandim ka gjetur zbatim, kjo e shoqëruar dhe me dokumentacion ligjor me shkresë nr.11/67 prot., datë 25.02.2025 "Për miratimin e shkallëve të vështirësisë në punë për punonjësit mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme.

Përsa më sipër 3 rekomandime kanë gjetur zbatim të plotë dhe 1 rekomandim është në proces. Niveli i rekomandimeve të zbatuara paraqitet në masën 75 % i cili konsiderohet i kënaqshëm, duke treguar qëndrim mbështetës ndaj rekomandimeve të auditimit.

Titullari i Drejtorisë së Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore duhet të njoftojë Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MSHMS mbi zbatimin e rekomandimeve me status "Në proces".

KONSIDERATA DHE FALENDERIME.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në MSHMS, falenderon grupin e punës të ngritur nga Titullari i Institucionit, për angazhimin dhe dhënien e dokumenteve të kërkuara dhe bashkëpunimin gjatë kohës së auditimit.

Raporti i auditimit mbi verifikimin e rekomandimeve hartohet në tre kopje, një prej të cilave adresohet në Drejtorinë e Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, një kopje administrohet në dosjen korente të këtij auditimi dhe një kopje administrohet në zyrën e protokollit të MSHMS.

Grupi i auditimit

Anesti Gjika

Flobec Guxho

